



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Adresa: Bulevardi "Zog I", Godina 57/2, Nr.18 Tiranë,

Tel/Fax: 04 2268141; 2268142

Nr. 959/15 Prot.

Tiranë, më 13.09.2016

V E N D I M

Nr.100, Datë 13/09/2016

Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes, në lidhje me zbatimin e ligjit në procesin e administrimit të shërbimit civil, në institucionin Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenin 11 pika 1, 14 dhe 15 të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", të ndryshuar, neneve 80-104 të ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", dispozita të cilat në mbështetje të nenit 185 të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", lejohet të veprojnë, si dhe të Rregullores "Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit", miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të materialit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Përgjithshme të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes, në lidhje me mbikëqyrjen e zhvilluar në institucionin, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, institucion në varësi të Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave,

VËREJ SE:

Me vendimin nr. 138, datë 30.12.2015 "Për kryerjen e mbikëqyrjes në lidhje me zbatimin e ligjit në procesin e administrimit të shërbimit civil, në Ministrinë e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave dhe në institucionet e varësisë që janë pjesë e shërbimit civil", është urdhëruar të fillojë mbikëqyrja e përgjithshme, në lidhje me administrimin e shërbimit civil në institucionin, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Objekti i mbikëqyrjes në këtë institucion është i përgjithshëm dhe ka përfshirë monitorimin, kontrollin dhe vlerësimin e zbatimit të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", të ndryshuar dhe akteve nënligjore, për të gjithë institutet e tij.

Administrimi i të dhënave dhe grumbullimi i dokumentacionit në subjekt filloi në datë 18.04.2016, sipas programit të mbikëqyrjes së përgjithshme të miratuar nga Komisioneri, me nr.959/1 prot., datë 30.12.2015, për Ministrinë e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave.

Në përfundim të procesit të verifikimit të dokumentacionit dhe grumbullimit të të dhënave, grupi i mbikëqyrjes ka hartuar projektraportin për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, dërguar për njohje subjektit të mbikëqyrur me shkresën nr. 959/9 prot., datë 25.07.2016 të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, duke i lënë 10 ditë kohë për të paraqitur komentet e tyre në lidhje me konstatimet e evidentuara nga grupi i mbikëqyrjes.

Projektraporti i mbikëqyrjes, i është dërguar për njohje, me shkresën nr. 959/10 prot., datë 25.07.2016, Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, dhe, me shkresën nr. 959/11 prot., datë 25.07.2016, Departamentit të Administratës Publike.

Në vijim të këtij procesi, me shkresën nr. 3113/1 prot., datë 05.08.2016 “*Observacion mbi projektraportin në përfundim të mbikëqyrjes në institucionin Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, në lidhje me administrimin e shërbimit civil*”, institucioni ka dërguar të nënshkruar projektraportin, së bashku me observacionet përkatëse, të cilat janë analizuar në përmbajtjen e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes.

Sa më sipër, çmoj se janë kryer të gjitha procedurat e nevojshme që sigurojnë transparencën e procesit dhe mundësinë e institucionit të kontrolluar për të shprehur pretendimet e tij, në lidhje me problematikën e evidentuar.

Në këto rrethana, pasi shqyrtova raportin përfundimtar të mbikëqyrjes, të paraqitur për miratim nga grupi i punës, vlerësoj se duhet të miratoj përmbajtjen e tij.

Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15 të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar, si dhe Rregulloren “*Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit*”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

V E N D O S A:

1. Të miratoj raportin përfundimtar të mbikëqyrjes së përgjithshme në lidhje me administrimin e shërbimit civil në institucionin Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, në varësi të Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, i cili do të jetë pjesë e këtij vendimi.
2. Njësia përgjegjëse, në zbatim të nenit 128 të ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999, “*Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë*”, të ndryshuar, duhet të ndryshojë aktet e deklaramit të statusit të punësimit, nga “*nëpunës civilë në periudhë prove*” në kategorinë “*nëpunës civilë*”, si më poshtë:
 - Akti administrativ nr. 2144/21, datë 15.08.2014, për deklaramin e statusit të punësimit “*Nëpunës civil në periudhë prove*”, për punonjësen *****, në pozicionin *Inspektore në Sektorin e Inspektimit të Ushqimit, Ushqimit për Kafshë me OSH dhe Operatorëve të Biznesit*, në Drejtorinë Rajonale të AKU - Qarku Tiranë.
 - Akti administrativ nr. 3267/8, datë 30.10.2014, për deklaramin e statusit të punësimit “*Nëpunës civil në periudhë prove*” për punonjësin *****, në

pozicionin *Inspektor në Sektorin e Inspektimit të Ushqimit, Ushqimit për Kafshë me OSH dhe Operatorëve të Biznesit*, në Drejtorinë Rajonale të AKU - Qarku Vlorë.

3. Njësia përgjegjëse, në zbatim të nenit 67, pika 3, të ligjit nr.152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar, të nxjerrë aktin e deklarimit të statusit të punësimit në kategorinë “*nëpunës civil*”, për punonjësen *****, në pozicionin *Inspektore në Sektorin e Inspektimit të Ushqimit, Ushqimit për Kafshë me OSH dhe Operatorëve të Biznesit* në Drejtorinë Rajonale të AKU - Qarku Tiranë.
4. Njësia e burimeve njerëzore të institucionit, të përfundojë procesin e hartimit të përshkrimeve të punës, për të gjitha pozicionet e punës pjesë e shërbimit civil, duke e vijuar këtë proces si më poshtë:
 - Të kërkojë zyrtarisht mendimin e Departamentit të Administratës Publike, për vlerësimin e ligjshmërisë së formularit të përshkrimit të punës për çdo pozicion pune në shërbimin civil, nëse është në përputhje me legjislacionin specifik të fushës apo formatin standard të miratuar.
 - Pas marrjes së konfirmimit nga njësia përgjegjëse (DAP), të vijojë procesi me miratimin dhe nënshkrimin e përshkrimeve të punës, nga Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave , në ndarjen përkatëse, siç parashikohet në pikën 18, shkronja “c”, të Vendimit nr. 142, datë 12.03.2014 të Këshillit të Ministrave, “*Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura*”, të ndryshuar.
 - Pas miratimit, nënshkrimit dhe dokumentimit të përshkrimeve të punës, një kopje e tyre, të bëhet pjesë e dosjes së personelit të çdo nëpunësi civil dhe një kopje të depozitohet pranë Departamentit të Administratës Publike.
5. Njësia përgjegjëse (DAP) dhe njësia e burimeve njerëzore të institucionit, të fillojnë procedurën për revokimin e akteve administrative, të cilat kanë dalë nëpërmjet emërimeve të përkohshme, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar, që parashikojnë plotësimin e një pozicioni të lirë pune detyrimisht nëpërmjet një procedure të rregullt konkurrimi, si më poshtë:
 - Revokimin e aktit administrativ nr.50, datë 01.02.2016, për emërimin e nëpunëses *****, në pozicionin “*Specialiste në Sektorin e Marrëdhënieve dhe Koordinimit Institucional*”, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të AKU.
 - Revokimin e aktit administrativ nr.73, datë 08.02.2016, për emërimin e nëpunësit *****, në pozicionin “*Specialist në Sektorin e Sistemit të Informimit të Shpejtë dhe Mbikëqyrjes së Tregut*”, në Drejtorinë e Vlerësimit dhe Komunikimit të Riskut, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të AKU.
 - Revokimin e aktit administrativ nr.80, datë 12.02.2016, për emërimin e nëpunëses *****, në pozicionin “*Inspektore (Ushqimi) në Sektorin e Koordinimit të Inspektorëve në PIK*”, në Drejtorinë e Menaxhimit të Riskut dhe Koordinimit të Inspektimit, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të AKU.

- Revokimin e aktit administrativ nr.78, datë 11.02.2016, për emërimin e nëpunësit ***** në pozicionin “*Inspektor në Sektorin e Inspektimit të Ushqimit, Ushqimi për kafshë me OSH dhe Operatorëve të Biznesit*”, pranë Drejtorisë Rajonale të AKU, Qarku Lezhë.
- Revokimin e aktit administrativ nr.107, datë 02.03.2016, për emërimin e nëpunësit ***** në pozicionin “*Përgjegjës në Sektorin e Shërbimeve të Brendshme*”, në Drejtorinë Rajonale të AKU, Qarku Dibër.
- Revokimin e aktit administrativ nr.72, datë 08.02.2016, për emërimin e nëpunësit ***** në pozicionin “*Përgjegjës në Sektorin e Shërbimeve të Brendshme*”, në Drejtorinë Rajonale të AKU, Qarku Lezhë.
- Revokimin e aktit administrativ nr.81, datë 12.02.2016, për emërimin e nëpunësit ***** në pozicionin “*Specialiste në Sektorin e Marrëdhënieve me Publikun dhe Ndërgjegjësimin të Konsumatorit*”, në Drejtorinë e Vlerësimit dhe Komunikimit të Riskut, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të AKU.
- Revokimin e aktit administrativ nr.82, datë 12.02.2016, për emërimin e nëpunësit ***** në pozicionin “*Inspektor në Sektorin e Inspektimit të Ushqimit dhe Ushqimit për Kafshë me OJSH dhe Operatorëve të Biznesit*”, pranë Drejtorisë Rajonale të AKU, Qarku Tiranë.
- Revokimin e aktit administrativ nr.88, datë 16.02.2016, për emërimin e nëpunësit ***** në pozicionin “*Inspektor në Sektorin e Inspektimit të Ushqimit dhe Ushqimit për Kafshë me OJSH dhe Operatorëve të Biznesit*”, pranë Drejtorisë Rajonale të AKU, Qarku Vlorë.
- Revokimin e aktit administrativ nr.143, datë 29.03.2016, për emërimin e nëpunësit ***** në pozicionin “*Inspektor në Sektorin e Kontrollit në Pikën e Inspektimit Kufitar*”, pranë Drejtorisë Rajonale të AKU, Qarku Durrës.
- Revokimin e aktit administrativ nr.142, datë 29.03.2016, për emërimin e nëpunësit ***** në pozicionin “*Inspektor pranë Sektorit të Inspektimit të Mbrojtjes së Bimëve dhe Inputeve Bujqësore*”, pranë Drejtorisë Rajonale të AKU, Qarku Lezhë.
- Revokimin e aktit administrativ nr.144, datë 29.03.2016, për emërimin e nëpunësit ***** në pozicionin “*Specialist në Sektorin e Shërbimeve Laboratorike*”, pranë Drejtorisë Rajonale të AKU, Qarku Tiranë.

Rekomandohet njësia përgjegjëse, që pozicionet e punës, që mbeten të lira pas revokimit të akteve të paligjshme, t’i shpallë vende të lira për t’u plotësuar nëpërmjet procedurës së konkurrimit.

6. Njësia e burimeve njerëzore të Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, si njësia përgjegjëse, të marrë masat e nevojshme për të realizuar kryerjen e ciklit të detyrueshëm të trajnimit në Shkollën e Administratës Publike (ASPA), për kategorinë e punonjësve në periudhë prove.

7. Njësia e burimeve njerëzore të institucionit, të përfundojë procedurën e vendimmarrjes në fund të periudhës së provës për punonjësit që u ka përfunduar periudha e provës, duke vepruar në këtë mënyrë:
- Të përfundojë procesi i vlerësimit të rezultateve në punë, në përfundim të periudhës së provës, sipas procedurave të përcaktuara në aktin nënligjor për vlerësimin e arritjeve vjetore.
 - Të administrohet në dosjen e personelit, së bashku me aktin e vlerësimit të punës, mendimi me shkrim nga nëpunësi civil më i vjetër, udhëzimet e të cilit ka ndjekur nëpunësi gjatë periudhës së provës.
 - Të administrohet në dosjen e personelit, rezultati i testimit në përfundim të ciklit të detyrueshëm të trajnimit në Shkollën e Administratës Publike (ASPA), si dhe çertifikata e lëshuar në këtë rast prej këtij institucioni.
 - Procesi duhet të përfundojë me vendimin e arsyetuar të eprorit direkt në përfundim të periudhës së provës, për secilin nëpunës që trajtohet sipas procedurave të mësipërme.
8. Njësia e burimeve njerëzore të institucionit, duhet të përfundojë procedurën e vlerësimit të rezultateve në punë për vitin 2015, për ata nëpunës, për të cilët, në formularët e vlerësimit, janë vërejtur mangësi, sipas rekomandimeve të materializuara në përmbajtjen e raportit të mbikëqyrjes.
9. Të plotësohet dosja e personelit me të gjitha dokumentet e evidentuara në mungesë në tabelat aneks, bashkëlidhur këtij raporti, sipas rekomandimeve në raportin e mbikëqyrjes.
10. Për kryerjen e këtyre veprimeve administrative, lihet afat **60** ditë nga marrja dijeni për këtë vendim. Institucioni i mbikëqyrur dhe njësia përgjegjëse, duhet të zbatojnë këtë vendim duke u bazuar në rekomandimet e dhëna në përmbajtjen e raportit.
11. Me kalimin e këtij afati, subjekti i mbikëqyrur, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, duhet të njoftojë me shkrim Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në lidhje me zbatimin e këtij vendimi.
12. Për këtë vendim të njoftohet Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave dhe Departamenti i Administratës Publike, duke i dërguar një kopje të raportit përfundimtar të mbikëqyrjes dhe njëkohësisht, të informohet Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut në Kuvendin e Shqipërisë.
13. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera STRAKOSHA